



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 07.11.2018

RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES ME VENDIN PRITËS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS RAJONALE PËR BASHKËPUNIM RINOR ”

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e **Komisionit përgjegjës**, në mbledhjen e datës 07.11.2018, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe zyrës rajonale për bashkëpunimin rinor”.

Komisioni për Politikën e Jashtme caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Andrea Marto.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm Zëvendësministrja për Evropën dhe Punët e Jashtme znj. Artemis Dralo, z. Ilir Melo, drejtor për rajonin dhe z. Armand Skapi, drejtor i traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Baza kushtetuese e projektligjit

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes me vendin pritës, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe zyrës rajonale për bashkëpunimin rinor.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje bëhet i mundur krijimi i kësaj zyre me seli në Tiranë, duke treguar kështu qartazi vullnetin politik dhe vizionin e ri që Shqipëria ka për rajonin.

Marrëveshja synon të formalizojë marrëveshjen e datës 4 korrik 2016 ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor për ngritjen e zyrës rajonale për bashkëpunimin rinor dhe vjen e ndarë në dy pjesë: preambulën dhe 24 nene, në të cilat parashikohen:

- privilegjet dhe imunitetet që do të gëzojë Zyra Rajonale për Bashkëpunimin Rinor;
- përjashtimi nga taksat, në të njëjtat kushte siç është parashikuar për misionet diplomatike të akredituara në Shqipëri;
- personaliteti juridik i saj; (ZRBR është themeluar si një organizatë ndërkombëtare dhe për këtë do të gëzojë personalitetin juridik që parashikon ligji në rastet e organizatave ndërkombëtare)
- sigurinë e godinës dhe pajisjeve apo materialeve që janë në pronësi të ZRBR;
- si dhe formën e hyrjes në fuqi të marrëveshjes.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon të mbështesë shkëmbimet rajonale të të rinjve, ndarjen mes tyre të ideve, bazuar në vlerat e tolerancës dhe respektit për të drejtat e njeriut, si dhe në angazhimin për gjithë përfshirje.

Efektet financiare

Zbatimi i marrëveshjes nuk sjell efekte të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit, por në kushtet e trajtimit të zyrës rajonale të bashkëpunimit rinor me status diplomatik, zyra do të përjashtohet nga taksat, në të njëjtat kushte siç është parashikuar për misionet diplomatike në Shqipëri.

Diskutime në Komision

Zv. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Artemis Dralo, në paraqitjen e saj shpjegoi se kjo marrëveshje është bazë për bashkëpunimin rinor në të ardhmen dhe përfshin vlerat e diversitetit me fokus në parimet e qeverisjes demokratike, zhvillimin e arsimit dhe inovacionit. Znj. Dralo sqaroi se angazhimi i Republikës së Shqipërisë në një nismë të tillë bëhet edhe në kuadër të marrëveshjes së stabilizim-asociimit dhe hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje është një hap pozitiv sa i takon thellimit të bashkëpunimit rajonal, si një prioritet i rëndësishëm për politikën e jashtme të Republikës së Shqipërisë.

Relatori, deputeti Andrea Marto theksoi se ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të tregojë edhe një herë përpjekjet serioze dhe të vazhdueshme të Republikës së Shqipërisë për të nxitur bashkëpunimin rajonal dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore në Ballkanin Perëndimor, dhe ftoi Komisionin që ta miratojë atë.

Gjatë diskutimit të projektligjit në komision, deputetët ngritën pyetje rreth krijimit të zyrës dhe trajtimin e saj si mision diplomatik, për të cilat morën shpjegime nga përfaqësuesit e ministrisë.

Në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

Në përfundim, Komisioni për Politikën e Jashtme shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me gjithë anëtarët e pranishëm, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATORI

KRYETARI

ANDREA MARTO

MIMI KODHËLI